



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Nr. 8064/2 prot.,
Tiranë, më 05.11.2018

Nr. 4215 prot.,
Tiranë, më 13.10.2018

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

Ministrisë së Kulturës/Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, e njohur më poshtë si “DDA”, e përfaqësuar me autorizimin nr. 8064/2 datë 02.11 /2018 të Ministrit të Kulturës, i cili vepron në bazë të Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;

Dhe

Autoritetit të Mediave Audiovizive, i njohur më poshtë si “AMA”, i përfaqësuar nga Kryetari, z. Gentian Sala, organ i pavarur, i cili vepron në bazë dhe për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Meqenëse:

- **DDA** - është strukturë e Ministrisë së Kulturës e cila ka për funksion njohjen dhe garantimin e respektimit të të drejtave të autorëve krijues dhe autorëve interpretues apo ekzekutues;
- **AMA** - është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Gjendja e rënduar nga mosrespektimi i të Drejtave të Autorit, të garantuara nga Neni 58 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, prej operatorëve audiovizive dhe subjekteve të tjera që ofrojnë shërbime për publikun në fushat e artit, ka sjellë pasoja të dëmshme për sa i përket vlerave reale të veprave letrare, artistike dhe atyre shkencore;

Palët, të angazhuara për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut e, në veçanti, në mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, bien dakord të lidhin këtë **Marrëveshje Bashkëpunimi** (më poshtë “**Marrëveshja**”), si më poshtë vijon:

Neni 1

Baza ligjore

1. Kjo marrëveshje bazohet në të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, si dhe në ligjet e tyre organike;
 - a) Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 58).
 - b) Në Konventën e Bernës, “Për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike”, nënshkruar në Bernë më 09.09.1986, plotësuar me Aktin e Parisit më 24.07.1971 dhe ndryshuar më 02.10.1979. (Aderimi me Dekret të Presidentit të Republikës nr. 487, datë 09.03.1993 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bernës “Për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike”).
 - c) Në Konventën e Romës, “Për mbrojtjen e artistëve interpretues dhe ekzekutues, të prodhuesve të fonogrameve dhe të organizmave të radiodifuzionit”, të nënshkruar në Romë më 26 tetor 1961. (Aderimi me ligjin nr. 8579, datë 16.02.2000, të Kuvendit të Shqipërisë “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për mbrojtjen e artistëve interpretues dhe ekzekutues, të prodhuesve të fonogramave dhe të organizmave të radiodifuzionit”).
 - d) Në Konventën e Gjenevës, “Për mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve kundër riprodhimit të paautorizuar të tyre”, nënshkruar në Gjenevë më 29 tetor 1971. (Aderimi me ligjin nr. 8585, datë 15.03.2000, të Kuvendit të Shqipërisë “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve kundër riprodhimit të paautorizuar të tyre”).
 - e) Në Konventën Universale, “Për të Drejtën e Autorit” dhe dy Protokollet shtesë të saj, nënshkruar në Paris, më 24 korrik 1971. (Aderimi me Ligjin nr. 9129, datë 08.09.2003, të Kuvendit të Shqipërisë “Për Aderimin e RSH në Konventën Universale të të Drejtës së Autorit dhe 2 protokollet shtesë të saj”).
 - f) Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.
 - g) Ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. (Ndryshuar me ligjin nr. 22/2016, datë 10.3.2016, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 27.7.2016 dhe ligjin nr. 91/2017, datë 22.5.2017)

Neni 2

Rëndësia

1. Respektimi dhe mbrojtja e së drejtës së autorit ka një rëndësi të veçantë në procesin e Integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për shkak të:
 - (i) detyrimeve të rëndësishme që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
 - (ii) angazhimeve të marra në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit që synojnë ndërmjet të tjerash, garantimin e luftës kundër piraterisë së produktit intelektual, si dhe respektimin e të Drejtave të Autorit në këtë fushë;
 - (iii) detyrimin që ka Shteti Shqiptar për zbatimin dhe respektimin e Konventave Ndërkombëtare, nëpërmjet institucioneve të tij, në fushën e pronësisë intelektuale, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar.

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është përcaktimi i modaliteteve dhe mënyrave të bashkëpunimit për shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve mes palëve, në kuadër të respektimit të përcaktimeve ligjore që rregullojnë fushën e transmetimeve audiovizive dhe atë të mbrojtjes së të drejtave të autorit, legjislacionit përkatës që rregullon fushën e transmetimeve audiovizive dhe të së drejtës së autorit, për të vendosur nën kontroll të gjithë tregun e pronësisë

intelektuale në fushën e artit, kulturës dhe shkencës, me qëllim garantimin e respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.

Neni 4

Përdorimi i informacionit dhe konfidencialiteti

1. Secila nga palët e kësaj marrëveshjeje do të përdorë informacionin e shkëmbyer vetëm në funksion dhe për qëllim të ushtrimit të funksioneve të veta ligjore.
2. Veprimet dhe shkëmbimet e informacioneve do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon detyrat dhe funksionet përkatëse të palëve.
3. Secila prej palëve ka detyrimin për të ruajtur informacionin që merr nga pala tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga aktet normative në fuqi.
4. Palët nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë palë të tretë informacionin që kanë marrë sipas kësaj Marrëveshjeje, pa marrë më parë miratimin paraprak të palës që jep informacionin.

Neni 5

Bashkëpunimi

1. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për realizimin e detyrave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e garantimit dhe mbrojtjes të së drejtës së autorit dhe forcimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në fushën e mediave audiovizive, bashkëpunimi, i cili do të përfshijë:
 - a) nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta që i shërbejnë zbatimit të kuadrit ligjor në fushat respektive;
 - b) shkëmbimin e informacionit lidhur me ankesat që vijnë nga OSHMA-të, lidhur me agjencitë e administrimit kolektive të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura;
 - c) shkëmbimin e informacionit mbi masat administrative/gjobë të përcjella nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) dhe koordinimin me AMA-n, për shkeljet e së drejtës së autorit, në mënyrë që të evitohet sanksionimi 2 (dy) herë për të njëjtën kundërvajtje administrative;
 - d) angazhimin reciprok për dhënien e kontributit në hartimin e akteve nënligjore në fushat respektive të mbuluara nga palët;
 - e) shkëmbimin e informacionit dhe rekomandimeve për çështjet që lidhen me të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.
2. Palët angazhohen që të zgjerojnë këtë bashkëpunim në masën që lejojnë dhe detyrojnë ligjet, në të cilat bazohet kjo marrëveshje bashkëpunimi, dhe që kanë të bëjnë me problemet e luftës kundër piraterisë dhe atë të pronësisë intelektuale.



Neni 6

Përmirësimet dhe ndryshime

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe shtesa në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
2. Çdo shtesë dhe ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e palëve ose nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

Neni 7

Pika e kontaktit

1. Secila prej palëve do të emërojë një përfaqësues, në cilësinë e personit të kontaktit, për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit, duke përshpejtuar afatet administrative, sipas formave që përcaktohen nga kjo marrëveshje bashkëpunimi.
 2. Palët kanë detyrimin të njoftojnë reciprokisht njëra tjetrën në rast se ndryshohet personi i kontaktit.
- 
- 

Neni 8
Komunikimi

1. Për efekt të zbatimit të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit, të caktuar nga secila prej palëve, do të marrin masat, që shkëmbimi i të dhënave dhe/ose informacioneve të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.
2. Për efekt të kësaj marrëveshjeje, komunikimet mes palëve do të bëhet me shkresë zyrtare.
3. Në raste urgjente, komunikimi mund të bëhet me e-mail, por, në çdo rast, ai duhet të dërgohet, më pas, edhe me shkresë zyrtare.

Neni 9
Afati i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën një muaj përpara.
3. Në rast të përfundimit të kësaj marrëveshje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, për sa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 10
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet sot, më datë 05 / 11 / 2018,
2. Kjo marrëveshje është hartuar në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë DDA-së, dhe dy kopje të tjera në AMA.
3. Marrëveshja hyn fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët.

**DREJTORIA E TË DREJTAVE TË
AUTORIT**

DREJTORI

SOFJAN JAUPAJ



**AUTORITETI I MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

KRYETAR

GENTIAN SALA

